



Raportimi për ambientin

Manual për gazetarë

Autori: Instituti për Politika Zhvillimore - INDEP

Fotot: Fatos Bytyçi

Programi: Qeverisje Demokratike

Publikimi: Prill 2023

Publikim i Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP). Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, ruhet në një sistem ose të transmetohet, në çfarëdo forme ose me çfarëdo mënyre, pa pëlqimin paraprak të botuesit. Publikimi mund të shpërndahet në formë elektronike, por vetëm në tërësi dhe vetëm për qëllime jokomerciale.

Ky publikim u mbështet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në Kosovë dhe qeveria e Japonisë përmes "Climate Promise Project".
"Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë

domosdoshmërisht pikëpamjet zyrtare të UNDP-së në Kosovë apo të qeverisë së Japonisë."

Hyrje

Ky manual u dedikohet gazetarëve kosovarë që duan të raportojnë për çështje që lidhen me ambientin. Çështjet mjedisore janë injoruar për disa dekada në Kosovë dhe tashmë dëmi i natyrës shihet në çdo cep të vendit. Ky manual u ndihmon gazetarëve sesi të raportojnë për këto çështje, ku t`i gjejnë idetë dhe si të mbrohen gjatë raportimit. Raportimi për ambientin shpeshherë përfshin çështje të komplikuara shkencore, mirëpo është detyra e gazetarit që ato t`i thjeshtësojë për çdo lexues, shikues ose dëgjues.

Para disa dekadash, shumë dhoma të lajmeve kishin gazetarë të specializuar për politikë, ekonomi, shëndetësi, çështje juridike, sport, kulturë etj. Në ditët e sotme, shumë media kanë gazetarë që merren vetëm më çështje të ambientit. Një gjë e tillëtashmë ka filluar edhe në Kosovë.

Çka përmban ky manual?

- Fillimisht, gazetarët dhe studentët që duan të merren me gazetari do të mund të shohin se si të vendosin nëse një storie ia vlen të realizohet.
- Do t'i shohin teknikat si ta bëjnë një intervistë të mirë.
- Asnjë storie për shkatërrimin e ambientit nuk mund të vërtetohet nëse nuk ka videoose foto. Ky manual tregon si duhet të filmohen storiet ose si të kemi foto të mira.
- Hulumtimi i çështjeve mjedisore do të shpjegohet në hollësi.
- Krijimi dhe ruajtja e burimeve gjatë raportimit.
- Nuk ka asgjë më të rëndësishme se siguria e gazetarit, kameramanit dhe fotografit.
- Çka ofron ligji në Kosovë dhe si i mbron gazetarët? Kë mund ta kontaktoni nëse merrni kërcënime?
- 10 këshilla nga një gazetar që ka marrë shumë shpërblime për raportimet e tij përmjedisin.
- Lista e institucioneve dhe organizatave joqeveritare që merren me ambientin.
- Ku mund t'i gjeni idetë për storiet për mjedis? Ne ju tregojmë për problemet mjedisore që mund të raportoni duke filluar nga sot.

Cili lajm vlen, cili jo (Pitching a story)

Para se të shkoni në terren, janë tri pyetje për të cilat duhet t'i dini përgjigjet:

- 1. Çka është storia?**
- 2. Çfarë intervistash më duhen për storien time?**
- 3. Çfarë pamjesh duhet të filmoj për storien time?**

Puna e gazetarëve është shumë dinamike dhe shumë shpesh ju nuk keni mundësi të mendoni për këto pyetje në redaksi. Mirëpo, nëse ndodh një tërmet apo është rrëzuar një aeroplan dhe jeni nisur për në vendin e ngjarjes, këto pyetje duhet t'ju vijnë në mendje. Merrini këto pyetje dhe vendosini në veshin tuaj si vath. Përgjigjja ndaj këtyre pyetjeve bën të mundur që të keni një kronikë të mirë televizive, foto të mira, video ose një tekst të mirë.

Çka është storia?

Kjo është pyetja më themelore dhe më e rëndësishme që e bën të mundur realizimin e stories. Pyetja i referohet gazetarit, kameramanit dhe fotografit, në mënyrë që ai/ajo të mendojë se çka duhet të bëjë. Mos u frikësoni si gazetarë të rinj, nëse ata që kanë punuar më herët kanë më shumë ide ose ide më të mira për storie interesante. Kjo vjen me përvojë. Sa më shumë të punosh në media, ke më shumë ide. Por, para se të fillonitë thoni se unë kam një storie të mirë dhe interesante, mendoni pak:

- Mendoni për një storie që ka një fokus dhe një "çka po ndodh"?
- Duhet të dini se çfarë storiesh i përkasin programit tuaj ku do të transmetohet ajo
- Për edicionin e lajmeve duhet një storie tjetër dhe një tjetër për një emision të llojit magazinë ku storiet janë më të gjata
- Cila është audienca juaj dhe cili është niveli i saj i të kuptuarit? Nuk mund të tregoni për rritjen ekonomike ose borxhin e një vendi në programin e fëmijëve
- Sa minuta duhet të jetë storia juaj? Një storie për lajme zakonisht është nga 1 deri në 2 minuta e gjysmë

Çfarë intervistash më duhen për storien time?

Pasi ta keni të qartë se çfarë fokusi ka storia juaj, është më lehtë që të identifikohen personat që duhet të intervistohen. Qartësia që tashmë keni se çka është storia, ju ndihmon shumë të dini se çka dëshironi të nxirrni, çfarë citatesh, nga personat që ju mendoni t'i intervistoni. Kjo ju ndihmon t'i përgatisni pyetjet në mënyrë që të merrni citatet që do të jenë sa më të mira për storien tuaj. Para se ta intervistoni dikë duhet t'i tregoni se kush jeni, për kë punoni dhe cila është storia. Nuk mundeni vetëm ta shtypni

butonin dhe të bëni një intervistë pambarim. Gjithmonë merrni të dy palët. Intervistoni personat që janë të përfshirë në storie. Është e rëndësishme që të gjithë të intervistuarit të paraqiten në mënyrë sa më objektive. Nuk guxoni ta paraqitni një intervistues si shpëtimtar e tjetrin si kriminel. Detyra juaj është të jeni të paanshëm. Junuk jeni gjyqtar, jeni vetëm gazetar.



Çfarë pamjesh duhet të filmoj?

Të marrim për shembull djegien e një mali të madh. Me siguri keni parë ose edhe mbuluar storie të ngjashme. Kur të arrini, e dini se çka duhet të bëni. Fillimisht duhet taruani veten dhe ekipin me të cilin punoni. Pastaj filloni të merrni pamje që do ta tregojnë ngjarjen. Nëse nuk jeni duke punuar për edicionin e lajmeve por dëshironi të bëni një reportazh më të gjatë, atëherë do të ishte mirë sikur fillimisht ta vizitonit vendin dhe më vonë të filloni filmimet. Mos harroni se shumë shpesh storia nuk do të duket ashtu siç keni menduar në fillim. Do të takoni persona të tjerë nga ata që keni menduar t'i intervistoni.

Hulumtimi para se të filloni të bëni storien

Çdo storie është e mirë vetëm atëherë kur ka hulumtim dhe përgatitje paraprake. Mund të keni gazetarin, fotografën, kameramanin ose montazherin më të mirë në botë, por historia juaj nuk do të duket mirë nëse nuk i keni kryer detyrat e shtëpisë më herët, për të marrë sa më shumë informata. Ju mund të keni një ide të mirë, por duhet ta bindni redaktorin për një PO, prandaj duhet të keni parasysh:

- A është relevante?
- A është ide origjinale apo e kopjuar nga dikush tjetër?
- A sjell emocione?
- A ndikon te njerëzit?

- A u intereson shikuesve?
- A do të flitet pasi storia ime të transmetohet?
- A është për programin ku punoj?
- A mund të bëhet?
- A mund të shkoj në atë vend?
- Sa mund të kushtojë?
- Sa kohë më duhet të shpenzoj?

Kur mendoni për një ide, dy gjëra duhet t'i keni në mendje dhe mos i harroni kurrë:

- MOS I BESO ASKUJT

- KONTROLLO ÇDO GJË


Momenti më i vështirë për një gazetar të ri është bindja e redaktorit se ka një storie të mirë. Ja disa këshilla se si NUK DUHET dhe si DUHET folur për idenë tënde:

NUK DUHET:

- Nuk është storie interesante por...
- Nuk e di nëse mund ta bëj këtë storie por...
- Ende nuk kam bërë kërkime por...
- Mos e nënvlerëso idenë tënde
- Mos e mbivlerëso idenë tënde

DUHET:

- Tregoni shumë bindshëm se cili është fokusi i stories
- Shpjegoni se si ndikon te shikuesit
- Tregoni shkurt se si do ta realizoni
- Tregoni se kur mund të jetë gati. Sa do të kushtojë. Për çfarë pajisjesh keni nevojë për storien tuaj



- Bëni paraprakisht kërkime për idenë tuaj
- Bëhuni i ndershëm



Intervista

Intervista është gjëja më e rëndësishme për një gazetar. Jeta juaj është intervistimi. Ju do të bëni lajme bazuar në ato se çka ju thonë njerëzit pasi t'i intervistoni dhe nëse nuk jeni intervistues i mirë, nuk do të mund ta shkruani një lajm të mirë.

Ka shumë lloje të intervistave ose mundësi kur gazetarët mund të bëjnë pyetje:

- Konferenca për shtyp
- Intervista e shkurtër për një storie
- Intervista e gjatë ballë për ballë
- Voxpops-at
- Intervista për një profil

Para se ta bëni ndonjërin prej këtyre intervistave, ja disa rregulla bazike:

Hulumtimi

Para se ta filloni intervistën, bëni kërkime për të intervistuarin. Hulumtimi paraprak ju bën të ndiheni rehat, të fokusuar dhe në fund do të keni një intervistë të mirë.

Fokusi

Kërkimi duhet të përdoret me mençuri. Vetëm sepse keni mësuar shumë për një person nuk do të thotë se duhet pyetur çdo gjë. Në fakt, kërkimi duhet të zbulojë se çka është e rëndësishme për t'u pyetur e çka jo. Shumë gazetarë mundohen ta mbarojnë kërkimin gjatë intervistës. Kjo i bën gazetarët të duken shumë keq dhe po ashtu të intervistuarit do të mund ta shesin propagandën e tyre.

Pyetjet e hapura

Pyetja duhet të jetë e formuluar mirë nëse doni të keni një përgjigje të mirë. Nuk duhet të bëni pyetje të cilat mund t'ju sjellin përgjigje Po ose Jo. Shumë shpesh pyetjes suaj mund t'ia shtoni një pse, si dhe çka, për të marrë një përgjigje të mirë.

Shembull:

Pyetje e mbyllur: A jeni kundër politikave ekonomike që janë prezantuar nga lideri i partisë suaj?

Përgjigjja: Po

Pyetje e hapur: Pse jeni kundër politikave ekonomike që janë prezantuar nga lideri i partisë suaj?

Edhe pse në shumicën e rasteve pyetjet e hapura ju ndihmojnë të keni një citat të mirë, me një intervistues hezitues vetëm pyetjet e mbyllura mund të bëjnë punë. Kjo po ashtu është e vërtetë për fëmijët e vegjël.

Pyetjet orientuese

Një pyetje orientuese domosdoshmërisht do të sjellë një përgjigje. Ato mund të përdoren për ta mbështetur pas muri një person që nuk dëshiron të japë një përgjigje të drejtpërdrejtë. P.sh. "A nuk mendoni se kjo është një çështje e vogël për të pasur një zënkë brenda partisë?"

Pyetjet hipotetike

Një pyetje hipotetike përdoret për të marrë mendimin e një personi ose organizate për një situatë që mund të ndodhë. P.sh. "Sa jeni të përgatitur ju si qeveri nëse një tërmet ndodh përsëri?"

Pyetjet hetuese

Një pyetje hetuese mund të nxisë intervistuesin që të japë informacione ose mendime. Kjo metodë është e mirë kur bëhen storiet hulumtuese. P.sh. "Çka nënkuptoni kur thoni se po e ndihmoni familjen e këtij fëmije, kur aktualisht e detyroni atë të punojë për një rrogë qesharake/të vogël?"

Pyetjet nxitëse

Një pyetje nxitëse është një pyetje dashamirësie që i ndihmon të intervistuarit ta formulojë një përgjigje që përputhet me kërkesat se çka dëshiron gazetari. P.sh. "Më tregoni pak, si erdhët këtu, sa gjatë bëtë të vinit këtu dhe çka mendoni për sistemin e transportit?"

Disa rregulla të vogla:

- Gjithmonë prezantohuni kush jeni dhe për kë punoni
 - Ashtu sikur në emisionin kush do të bëhet milioner, edhe ju filloni me pyetje të lehta dhe më vonë kaloni në pyetjet e vështira
 - Gjithmonë mësojeni emrin e të intervistuarit para se ta filloni intervistën
- Sekreti kryesor të intervista është dëgjimi. Dëgjoni mirë dhe ndërhyini gjatë intervistës
- Kurrë mos u vononi në intervistë. Edhe 15 minuta më herët është më mirë

Dhjetë rregullat se si të bëhet një intervistë:

1. Përgatitja. Shkoni në intervistë i përgatitur. Edhe 10 minuta mjaftojnë për t'u përgatitur, sesa të shkoni duarthatë

2. Tri këshilla të vogla. Bëhuni këmbëngulës, i sjellshëm dhe profesional. Dukja është e rëndësishme. Dukuni profesional. Buzëqeshni

3. Incizoni. Gjithmonë incizojeni intervistën. Tregojuni të intervistuarve se kjo është për të dyja palët, që më vonë të mos ketë keqkuptime

4. Shkurt dhe ëmbël. Bëj pyetje të shkurta, të qarta, të hapura. Nëse jeni i përgatitur do të dukeni shumë profesionist dhe mund të bëni pyetje si: "Javën e kaluar ju keni thënë..." ose "Gjatë fushatës zgjedhore ju keni premtuar..."

5. Ata flasin, ju dëgjoni. Lëreni të intervistuarin të flasë. Dëgjimi i vëmendshëm është vendimtar. Ndërhyini gjatë intervistës shumë sjellshëm, vetëm nëse e shihni se personi po bën monolog

6. Ndërhyini. Bëni më shumë pyetje specifike ose siç njihet në gazetari follow-up. Ndërhyini gjatë intervistës nëse mendoni se mund të nxirrni më shumë detaje ose citate më të forta





7. Përsëriteni lajmin kryesor. Përsërisni numrat ose atë çka mendoni se është e rëndësishme për ta qartësuar ose konfirmuar. Konfirmojeni fjalinë kryesore që mendoni se mund të jetë lajmi juaj nga intervista

8. Nuk është fundi derisa ju thonë. Kurrë mos e mbaroni intervistën derisa t'ju thonë se ajo ka përfunduar

9. Pyetja gjithëpërfshirëse. Përfundojeni me një pyetje të përgjithshme që mendoni se ai/ajo mund t'ju tregojë diçka që mund të jetë e rëndësishme. Mund ta pyesni intervistuesin: "A ka diçka që ju doni të thoni që nuk e kemi mbuluar?"

10. A mund të takohemi përsëri? Mundohuni të lini takim për herën tjetër derisa jeni duke e përfunduar intervistën e tanishme

Filmimi i lajmeve dhe storieve

Disa rregulla se çka duhet të bëni para se t'i filloni xhirimet:

Flisni me kameramanin/fotografin: Storia juaj bazohet në pamjet që i xhironi. Nëse kameramani/fotografi nuk e di se çka dëshironi ju dhe me çfarë pamjesh do ta mbuloni tekstin, atëherë storia nuk do të jetë aq e mirë. Para se t'i filloni xhirimet, tregoni kameramanit/fotografit se cila është historia dhe si keni menduar ta filmoni. Po ashtu jepjani mundësinë kameramanit/fotografit që t'i tregojë shkathtësitë dhe nëse aika një ide më të mirë, pranojeni idenë e tij/saj.



Mësoni si filmohen storiet: Ju duhet të dini si filmohen storiet, në mënyrë që gjatë xhirimeve të dini se çfarë pamjesh keni dhe çka ju mungon. Një gazetar imirë e di se çfarë pamjesh ka vetëm duke i parë lëvizjete kameramanit në terren.

Merrini pajisjet e nevojshme: Gjithmonë kontrolloni dy herë nëse i keni të gjitha pajisjet: kamerën, trekëndëshin (apo si do ta quajmë ne Trajpod), bateritë mbushura, mikrofonin, kartat, dritat etj.

Xhirimi në kohën e duhur: Nëse mendoni se një vend duhet të xhirohet në mëngjes, mos e xhironi në mbrëmje. Shkoni gjithmonë në kohën dhe vendin e duhur për të xhiruar.

Gjithmonë përdoreni trajpodin: Sugjeroni gjithmonë kameramanin që ta përdorë trajpodin. Mos harroni se ka kameraman të mirë që mund të filmojnë edhe nga krahu, mirëpo ata kurrë nuk mund ta zëvendësojnë trajpodin. Ka ngjarje që duhet të xhirohen nga krahu sepse nuk pret koha. Vendosja në vend e trajpodit merrdisa sekonda dhe disa sekonda janë të mëdhenj për një xhirim të mirë.

Mbajini sytë hapur: Derisa kameramani bën xhirimet, gazetari duhet të shikojë për ndonjë pamje që mund të ndodhë, por kameramani nuk e sheh në ato momente sepse është i zënë me xhirime të tjera. Ju duhet ta njoftoni atë. Mos e lini kameramanin të marrë pamje dhe ju të shkoni për kafe. Gjërat mund të ndryshojnë për disa sekonda.

JU NUK JENI DUKE BËRË FILM. KUJDES, PAMJET QË JU DËSHIRONI NUK MUND TË PËRSËRITEN

Tregimi pamor

Përpara xhirit, është thelbësore të keni kuptuarstorien. Hulumtimi duhet të kryhet duke përdorur burime të ndryshme si gazetatat e shtypura, TV, mediat online dhe platformat e mediavesociale.

ë për të biseduar me njerëzit përkatës, vëzhgojeni zonën mit, parashikojini skenarët e xhirimeve, merrini parasysh përcaktojeni vendndodhjen më të mirë për xhirimet.

Si autor i tregimit, nëse nuk keni një kuptim të qartë të temës, do të jetë e vështirë t'ia përcillni në mënyrë efektive mesazhin shikuesit. Përgatitja është çelësi i suksesit në çdo projekt xhirues.

Pajisjet e xhirit

Thënia "kamera më e mirë është ajo që keni në dorë" thekson rëndësinë e shfrytëzimit maksimal të pajisjeve që keni, në vend që të fokusoheni vetëm në marrjen e teknologjisë më të fundit.

Është thelbësore t' i kuptoni pikat e forta dhe kufizimet e pajisjeve tuaja dhe të bëni rregullime në teknikën e filmimit në përputhje me rrethanat. Të kesh pajisje më të mira nuk do të çojë domosdoshmërisht në rezultate më të mira, nëse nuk dini t' i përdorni ato siç duhet.

Edhe në mesin e transmetuesve të njohur, kamerat HD përdoren ende gjerësisht për programet e lajmeve. Aspekti më i rëndësishëm është të dini si t' i përdorni në mënyrë efektive pajisjet që keni, në vend që të mbështeteni vetëm në teknologjinë më të fundit.

Filmimi me telefonin tuaj

Çdo smartphone ka specifikat e veta unike të kamerës. Kur filmimi me një telefon inteligjent, përgjithësisht rekomandohet të xhironi në Full HD (FHD).

Në rastet kur diapazoni i zmadhimit të një telefoni inteligjent është i kufizuar, filmimi në 4K mund të ofrojë opsionin për të zmadhuar gjatë postproduksionit, për të përmirësuar stabilitetin e filmimit dhe për të lejuar rikuadrimin e shkrepjeve. Megjithatë, filmimi në 4K do të rezultojë në përdorim më të shpejtë MemoryCard, kohë më të gjata transferimidhe ulje të performancës së kompjuterit.

Çfarë formati të filmojmë/fotografojmë?

Formati i filmimit 16:9 përdoret gjerësisht në transmetimet televizive dhe përmbajtjet video në internet.




Megjithatë, platformat e mediave sociale shpesh përdorin një sërë formatesh të tjera, si p.sh. 9:16 për videot me histori, 4:5 për videot portrete dhe 1:1 për videot katrore.

Është e mundur të ndryshohet raporti i pamjes gjatë montimit. Shumë programe të editimit të videove, si Adobe Premiere Pro, kanë konvertues të automatizuar të raportit të pamjes për ta thjeshtuar procesin. Kjo ju lejon ta përshtatni përmbajtjen e videos në platforma të ndryshme dhe të siguroheni që të duket më e mira, pavarësisht se ku po shikohet.

Teknikat e xhirimit

Rregulli i Të Tretave (Rule of Thirds)

Rregulli i të tretave është një udhëzues kompozimi i përdorur gjerësisht në fotografi dhe video. Ai sugjeron ndarjen e kornizës në të tretat horizontalisht dhe vertikalisht dhe vendosjen e subjektit përgjatë njërës prej linjave ose në kryqëzimin e tyre. Kjo krijon një



imazh të ekuilibruar dhe tërheqës vizuelisht.

Shumë kamera dhe telefona kanë një veçori të integruar të rrjetit që shfaq rregullin e të tretave, duke e bërë më të lehtë ndjekjen. Është një pikënisje e mirë për ata që janë të rinj në kompozimin e videove ose fotografive, por nuk duhet të jetë e vetmja mënyrë për t'i kompozuar fotot tuaja. Ndërsa fitoni më shumë përvojë dhe njohuri, mund të eksperimentoni me kompozime të ndryshme dhe t'i gjeni ato që funksionojnë më mirë për stilin dhe temën tuaj.

Xhirimet në sekuenca

Është shumë e rëndësishme që i njëjti veprim/i njëjti mjedis të filmohet në sekuenca. Xhirimi në sekuenca është një aspekt kyç i prodhimit të videos, pasi ofron opsione të shumta për modifikim dhe ndihmon në ruajtjen e vazhdimësisë së skenës. Filmimi në madhësi të ndryshme të kuadrove dhe kënde të kamerës krijon një rrjedhë të qetë dhe ndihmon në shmangien e ndërprerjeve në videon përfundimtare të modifikuar. Duke përdorur të njëjtin veprim dhe cilësim, mund të krijoni një iluzion të filmimit me shumë kamera, duke e bërë produktin përfundimtar të duket më profesional.



Gjatësia e pamjes

Të gjitha shkrepjet e filmuara duhet të zgjasin rreth 10 sekonda, në realitet do të përdorni më pak, por duhet t'i merrni parasysh dridhjet e kamerës kur shtypni "Record and stop". Mënyra për t'i numëruar sekondat është të numëroni në kokën tuaj 1000 e një, 1000 e dy....

Qëllimi është që t'i keni të paktën 6 sekonda filmime të përdorshme në rastet kur filmoni një shenjë të thjeshtë, që do t'ju duhen në montim rreth 3 sekonda. Ka raste kur filmohet një tabelë me shumë informacion, duhet ta filmoni edhe më gjatë se 10 sekonda. Në fund të fundit, fotografia duhet të jetë aq e gjatë sa ju nevojitet për ta lexuar me një shpejtësi normale. Nëse ndonjë veprim i jashtëzakonshëm përndodh para jush, vazhdoni të regjistroni për aq kohë derisa të kryhet ai veprim.

Kuadri i gjerë (Establishing Shot)

Kuadri i gjerë është i rëndësishëm pasi i jep kontekst shikuesit, ndihmon në orientimin e tij drejt vendndodhjes dhe krijon një referencë vizuale që shikuesi ta kuptojë pjesën tjetër të stories. Zakonisht është një pamje e gjerë që mund të jetë e një horizonti të qytetit, një ndërtesë, një parku ose ndonjë vendndodhjeje që ka lidhje me storien.

Pamja hapëse (Opening shot)

Në video kjo pamje duhet të jetë ajo që keni më të mirën, më të fortën. Duhet të jetë vizuelisht bindëse, të tërheqë vëmendjen dhe të vendosë tonin për pjesën tjetër të tregimit.

Vija imagjinare

Le të imagjinojmë se po filmoni protestuesit duke marshuar, po filmoni një sekuencë nga ana e tyre e majtë dhe ata po lëvizin në pamjen tuaj nga e djathta në të majtë. Nëse kaloni rrugën për të filmuar një sekuencë tjetër, gjithçka do të jetë e kundërta e asaj që keni filmuar më parë, protestuesit do të



lëvizin nga e majta në të djathtë. Kjo shkakton konfuzion te shikuesi, pasi duket sikur ata po vijnë dhe më pas po largohen. Kjo është vija imagjinare. Mund të kalohet në një situatë proteste duke filmuar një pamje neutrale, si një pamje p.sh. para protestuesve që janë duke ardhur drejt jush. Vija imagjinare duhet të merret parasysh edhe në intervista, ku drejtimi i kokës së të intervistuarit duke folur duhet të jetë gjithmonë në të njëjtën anë të kuadrit.

Subjektet që hyjnë dhe dalin nga kuadri

Kur filmoni një person ose grup personash, automjete, kafshë etj., lini ata të largohen nga kuadri. Kjo ju mundëson të montoni më lehtë.

Pamjet lidhëse (Cutaway)

Cutaway është një pamje që ndihmon në montimin e dy sekuencave ose pamjeve që nuk përshtaten së bashku. Ndhmon në kalimin e vijës imagjinare, si dhe në ndryshimin e vendndodhjeve.

Në një intervistë mund të jenë duart, pamje ekstreme nga afër, diçka që ka rëndësi me storien që po e bëni.

Rëndësia e audios në një video

Audioja në një video storie është thelbësore sepse ndihmon për të vendosur tonin dhe atmosferën e skenës, dhe gjithashtu mund t'i përcjellë shikuesit informacione të rëndësishme. Audioja mund të përdoret për të krijuar një ndjenjë tensioni ose drame, apo për të dhënë informacion në sfond nëpërmjet dialogut ose rrëfimit. Përveç kësaj, audioja mund të përdoret gjithashtu për të drejtuar vëmendjen e shikuesit, duke theksuar disa elementë të skenës ose duke drejtuar fokusin e shikuesit në zona të

veçanta. Në përgjithësi, audioja në një video storie luan një rol jetik në krijimin e një eksperience gjithëpërfshirëse dhe tërheqëse për shikuesin.

Gazetaria hulumtuese mjedisore

Studiues të medias kanë dhënë përkufizime të ndryshme sa i takon gazetarisë hulumtuese mjedisore. Por shpjeguar thjeshtë dhe me pak fjalë, gazetaria hulumtuese mjedisore nënkupton: identifikimin, mbledhjen, verifikimin, përpunimin dhe shpërndarjen e informacioneve që trajtojnë ngjarje të çështjeve mjedisore. Pra, nënkupton hulumtimin e temave që lidhen me natyrën dhe mjedisin, veçanërisht ndikimin e aktivitetit njerëzor në shkatërrimin e mjedisit. Përveç shpërfaqjes së dukurive negative, një prej misioneve kryesore është ndërgjegjësimi i qytetarëve. Gazetaria hulumtuese është mjaft atraktive por përcjell më vete shumë sfida, që nga faza fillestare e hulumtimit, kontaktimi dhe marrja e përgjigjeve nga institucionet dhe personat përgjegjës e deri te rreziku që mund të paraqitet gjatë rrugës.

Nga t'ia nisim, kush i ka informacionet që na duhen?

Faza fillestare e çdo hulumtimi duhet të përfshijë një analizë të hollësishme të mënyrës se si do të realizohet hulumtimi, çfarë synojmë të nxjerrim në pah dhe cili do të jetë ndikimi pas publikimit.

Në fazën e parë gazetarët duhet të kujdesen që të dinë se cilat janë institucionet apo personat përgjegjës që mund t'i kenë informacionet e nevojshme. Disa prej tyre janë:

- Autoritetet qendrore, përfshirë kryeministrin, ministrat, agjencitë e pavarura, inspektoratet etj.
- Autoritetet lokale, përfshirë kryetarin e komunës, drejtorët komunalë, inspektoratin komunal etj.
- Këshilltarët komunalë
- Deputetët
- Vendimmarrës të tjerë
- OJQ-të
- Bizneset
- Studiuesit
- Qytetarët

Si t'i kultivojmë burimet tona?

Një nga segmentet kryesore që e bëjnë një hulumtim të suksesshëm dhe me ndikim është edhe hartimi i një plani të identifikimit, kontaktit dhe komunikimit me burimet e informacionit, përfshirë këtu zyrtarët, qytetarët, sektorin joqeveritar, si dhe grupet e ndryshme të interesit.

Disa këshilla të vlefshme:

- Identifikimi i kujdesshëm i burimeve të informacionit
- Kontakti i kujdesshëm dhe profesional
- Takimi në katër sy
- Ndërtimi i besimit të ndërsjellë
- Shmangia e gënjeshtërs
- Kujdesi i shtuar në ndarjen e informacioneve
- Menaxhimi me maturi i situatës në rast të pakënaqësive pas publikimit
- Mbetja në kontakt pas publikimit

Kujdesi në komunikim

Hulumtimet zakonisht përmbajnë informacione konfidenciale, prandaj institucionet, bizneset dhe grupet e interesit angazhohen që ta parandalojnë publikimin e tyre.

Publikimi i informacioneve konfidenciale mund të ketë pasoja materiale por edhe ligjore për këto institucione dhe individë që mund të jenë të interesuar ta pengojnë punën tuaj. Andaj, çdo gazetar që është duke punuar në hulumtime që përmbajnë informacione të tilla, duhet të ketë kujdes në mënyrën e komunikimit. Gazetarët hulumtues, por edhe njohësit e fushës së komunikimit sugjerojnë që:

- Gazetari t'i shmangë sa më shumë diskutimet për temën në komunikime telefonike
- Të insistohet në takime sy me sy
- Të përdorë aplikacione të sigurta për komunikim



Aplikacionet e sigurta

Studime të shumta kanë treguar se çdo gjë që thuhet në “internet” është publike, pavarësisht se cilin aplikacion apo formë të komunikimit përdor. Megjithatë, aktualisht janë disa aplikacione që konsiderohen më të sigurta për të komunikuar.

- Whatsapp
- Signal
- Telegram

Këto tri aplikacione janë vetëm disa nga shumë aplikacionet që kanë “end-to-end encryption”. Enkriptimi “end-to-end” është një metodë sigurie që i mban të sigurta bisedat dhe mesazhet, ku vetëm përdoruesit që komunikojnë mund të kenë qasje në to.

Marrëveshja “Off the record”

Burimet e informacionit, që mund të jenë persona me pozita të ndryshme, zakonisht hezitojnë të komunikojnë apo ndajnë informacione me gazetarët. Studime të ndryshme tregojnë se sidomos në gazetarinë hulumtuese mjedisore, viteve të fundit siguri i informacioneve është duke u bërë më i vështirë sesa në sektorët e tjerë.



Por gazetarët duhet të insistojnë që së paku të flasin me këta persona, bazuar në marrëveshjen “Off the record”. “Off the record” në gazetari është një lloj marrëveshjeje ‘e pashkruar’ e cila e obligon gazetarin që komunikimin të mos e zbulojë publikisht.

Pse është e rëndësishme kjo marrëveshje?

- Burimi sigurohet se nuk do të ketë pasoja
- Sigurohet se nuk do të identifikohet se kush e ka nxjerrë informacionin
- Forcon besimin me gazetarin
- Ndan informacione të tjera në të ardhmen

Por, çfarë duhet të dijë burimi juaj?

Gazetarët duhet ta sigurojnë burimin e informacionit se marrëveshja “off the record” nënkupton se gazetarët mund të raportojnë atë që u është thënë, por nuk do t’u atribuohen atyre drejtpërdrejt në artikullin e publikuar. Por, në disa raste gazetarët mund t’i publikojnë këto informacione, gjithmonë duke ruajtur anonimitetin e burimit të informatës. Kur mund të ndodhë publikimi i informacioneve të siguruara në një takim “off the record”?

- Kur gazetari është i sigurt se nuk zbulohet burimi i informacionit
- Kur informacioni i ndarë është i një interesi të lartë publik
- Kur informacioni ka ndikim të madh në jetën e qytetarëve
- Kur rrezikohet jeta e individëve apo një grupi të qytetarëve

Puna në terren

Sigurisht se hulumtimet më të mira i dërgojnë gazetarët në vende të pasigurta ku mund të jenë pre e kërcënimeve dhe sulmeve fizike. Studimet e organizatave që merren me sigurinë e gazetarëve tregojnë se në dekadën e fundit, numri i gazetarëve që janë

sulmuar më së shumti është i atyre që raportojnë për çështje të ambientit. Janë disa rregulla universale se si duhet vepruar në rastet kur kryejmë hulumtime në terren.

Këto janë disa prej rregullave:

- Mos shkoni i vetëm në terrene me rrezikshmëri të lartë
- Tregoni redaktorit, kolegut apo familjarit për kohën, vendin dhe orën
- Mos i takoni i vetëm personat e dyshuar/akuzuar për shkatërrim të ambientit

Burimet primare dhe sekondare

Hulumtimi zakonisht përmban informacione të ndryshme të cilat janë risi për opinionin publik. Ato janë informacione të cilat nuk janë publikuar më parë dhe ndikimi i tyre mund të jetë i rëndësishëm në luftimin e dukurive negative. Ekzistojnë dy lloje të burimeve në të cilat gazetarët i bazojnë apo përmes së cilave gazetarët i argumentojnë artikujt e tyre. Janë burimet primare dhe ato sekondare.

Burimet primare

Burime primare konsiderohen materialet origjinale që përdoren për t'i argumentuar hulumtimet. Ato i takojnë periudhës për të cilën raportohet.

Burim primar konsiderohen:

- Fotografitë
- Video-regjistrimet
- Audio-regjistrimet
- Dokumentet zyrtare
- Transkriptet e takimeve
- Intervistat
- Të tjera


Burimet sekondare

Burimet sekondare përdoren pas fakteve dhe në përgjithësi përfshijnë interpretimin ose vlerësimin e materialit burimor kryesor.

Te burimet sekondare futen:

- Raporte

- Analiza
- Libra
- Artikuj revistash
- Tekste historike
- Kritika
- Komente
- Enciklopedi
- Tekste shkollore
- Të tjera



Gazetaria hulumtuese, pre e presionit

Sado sfidues mund të jetë siguri i informacioneve për ta argumentuar hulumtimin, sfidat për gazetarët në të shumtën e rasteve rriten si pasojë e presioneve me të cilat ata përballen. Gazetarët përballen me dy lloj presionesh:


Presioni i brendshëm: **brenda redaksisë**

Presioni jashtëm: **politika, grupet e interesit**

Presionet e brendshme mund të shfaqen qysh në fazat e para të prezantimit të temës, krijimit të një plani për hulumtim, zhvillimit të intervistave, shkrimit e deri te publikimi.

Disa nga format e presioneve të brendshme:

- Presioni nga mungesa e mjeteve financiare për punën në terren
- Presioni për ta kryer më shpejt hulumtimin

- 
- Presioni për ta publikuar më shpejt hulumtimin
 - Presioni për të mos raportuar për zyrtarë, biznese të caktuara, financues të medias

Presioni i jashtëm

Në shumicën e rasteve presioni i jashtëm është më lehtë i menaxhueshëm për gazetarët. Megjithatë, di të jetë stresues dhe bëhet i vështirë sidomos në rastet kur redaksitë nuk e kanë fuqinë apo nuk i mbështesin gazetarët. Disa prej burimeve prej nga mund të vijë presioni i jashtëm:

- Presioni nga zyrtarët qeveritarë, zyrtarët lokalë, agjencitë e pavarura
- Presioni për ta penguar hulumtimin nga kompanitë dhe grupet e interesit
- Presioni përmes kërcënimit fizik
- Presioni përmes ushtrimit të padive SLAPP (Padi strategjike kundër pjesëmarrjes publike)

Pse duhet ta njohim ligjin?

Gazetarët duhet të njohin fusha të ndryshme të ligjit, veçanërisht ato në lidhje me informacionin që duhet dhe nuk duhet ta marrin nga individët apo zyrtarët, si dhe të drejtën për të publikuar këtë informacion apo jo. Ekzistojnë shumë rekomandime nga studiues të mediave, por edhe nga institute të ndryshme, për mënyrën se si duhet të përdoren dokumentet që gazetarët i sigurojnë, qoftë në formë zyrtare apo jozyrtare.

Dokumentet që mund të përdoren:

- Dokumente qeveritare
- Vendime zyrtare të institucioneve
- Analiza dhe raporte të institucioneve
- Procesverbale
- Korrespondenca institucionale
- Analiza ligjore

- Raporte statistikore
- Të tjera

Dokumentet që merren me rezervë apo nuk përdoren

Jo çdo dokument që gazetari siguron mund të publikohet. Në shumë raste, zyrtarë, grupe të interesit mundohen që t'i lajthitin gazetarët. Ata ndodh që u japin atyre në dispozicion dokumente me përmbajtje të rrejshme, dezinformuese. Andaj dokumentet në vijim duhet të konsiderohen me kujdes të shtuar:

- Dokumente të kopjuara
- Dokumente pa nënshkrim dhe vulë
- Dokumente pa emër të institucionit dhe të zyrtarëve përgjegjës
- Dokumente të inteligjencës

Hapat para publikimit të hulumtimit të dokumenteve

Janë disa praktika që duhen ndjekur para se të vendosim për publikimin e pjesshëm apo të tërësishëm të një dokumenti:

- Të sigurohemi se janë marrë në mënyrë ligjore
- Ta verifikojmë autenticitetin
- T'i rikonfirmojmë zyrtarisht apo përmes burimeve tona

Këshilla kryesore:

“Jini të vetëdijshtëm për atë që po raportoni dhe raportoni vetëm atë që mund ta argumentoni”

Siguria gjatë raportimit

Raportimi për tema mjedisore

Në të kaluarën u është kushtuar pak rëndësi mjedisit dhe gazetarëve që kanë raportuar për çështje mjedisore, por kjo ka ndryshuar shumë në dhjetëvjeçarin e fundit.

Drejtuesi i Qendrës "Knight" për Gazetari Mjedisore në Universitetin Shtetëror të Miçiganit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Eric Freedman, e ka përshkruar raportimin për gazetari mjedisore si një nga "rreziqet më të mëdha në gazetari".

Kjo për shkak se gazetarët që mbulojnë mjedisin shpesh trajtojnë çështje të ndjeshme ose tema që përfshijnë biznese me ndikim, aktivitete kriminale apo incidente me rrezik të lartë.

Një raportin e publikuar "Klimë armiqësore për gazetarët mjedisorë" nga organizata "Reporterët pa Kufij" thuhet se "gazetarët e mjedisit kërcënohen fizikisht, sulmohen dhe ndonjëherë janë vrarë për shkak të asaj që ata raportojnë. Niveli i dhunës në të cilin janë ekspozuar nuk ka qenë kurrë më i lartë".

Parapërgatitjet për terren

Me gjithë rreziqet dhe kërcënimet në rritje, gazetarët kanë rol të veçantë në ndryshimin e narratives rreth degradimit të mjedisit dhe fenomeneve të tjera negative, duke u bërë kështu pjesë thelbësore e zgjidhjes. Por, para se gazetarët të nisen në terren, duhet ta krijojnë një plan të detajuar sa i takon sigurisë personale dhe të ekipit.

Ekzistojnë udhëzues të ndryshëm se si duhet vepruar në rastet kur gazetarët përballen me rreziqe dhe masat që duhen marrë para nisjes për në terren. Një prej tyre është edhe "Udhëzuesi për Sigurinë e Gazetarëve – Udhëzues për gazetarët në mjedise me rrezik të lartë" i publikuar nga organizata "Reporterët pa Kufij" dhe UNESCO. Më poshtë janë disa rregulla praktike për mënyrën se si mund ta realizojmë një hulumtim në mënyrë të planifikuar, të sigurt dhe me ndikim.

Vlerësojini me kujdes rreziqet përpara se të shkoni në terren. Bëjani vetes këto pyetje:

- A di mjaftueshëm për vendin ku po shkoj?
- A kam informacione të mjaftueshme për rreziqet që mund të më shfaqen?

- Cilat janë rreziqet e mundshme dhe sa mirë jam i përgatitur për t'i përballuar ato?
- Kush dhe çka mund të jetë kërcënim për mua?
- Në veçanti, a jam i vetëdijshëm se si sillen individët/popullata lokale ndaj gazetarëve?
- A është tema e rëndësishme mjaftueshëm për t'i justifikuar rreziqet që po i marr?
- A kam bërë një plan për të qëndruar në kontakt me zyrën dhe familjen time?
- A dua vërtetë të shkoj dhe a jam gati fizikisht dhe psikologjikisht?
- A i kam pajisjet e nevojshme?

Raportimi për materiale të rrezikshme

Në punën e përditshme të gazetarëve që raportojnë për mjedisin, ndodh që ata të raportojnë për materiale të rrezikshme. Jo rrallëherë ata vizitojnë vendet ku janë duke u ruajtur materiale të rrezikshme për shëndetin e njerëzve dhe të banorëve lokalë. Por, kur trajtojmë një temë të tillë dhe planifikojmë të kryejmë punë në terren, janë disa aspekte që duhen pasur parasysh. Këto janë disa prej informacioneve më të rëndësishme që duhet t'i kemi para nisë për në terren:

- T'i mbledhim informacionet e nevojshme për materiale
- Ta kuptojmë rrezikun që paraqesin
- Ta kemi të qartë se si ta shmangim rrezikun nga ekspozimi ndaj tyre
- Të konsultohemi me banorët e zonës
- Ta dimë se cila është distanca maksimale që mund të ofrohemi
- T'i sigurojmë mjetet e nevojshme mbrojtëse: maska, këpucë speciale, rroba speciale dhe pajisje të tjera, varësisht nga rrezikshmëria e materialit

Raportimi nga terrene të vështira

Hulumtime më të mira gjenden në zonat rurale apo zonat e thella ku syri i publikut nuk është në kontakt të vazhdueshëm me pamjen. Sidomos në raportimin për çështje mjedisore, temat më të mira gjenden në zona të thella, pasi degradimi i maleve, lumenjve, tokave dhe veprimtaria e gurëthyeseve është e zhvilluar në këtë zonë, largsyrit të publikut. Raportimi për këto tema kërkon përgatitje specifike.

Masat para nisjes për në terren

- Ta identifikojmë lokacionin e saktë
- Të dimë saktë sa është distanca me vendbanimin më të afërt
- Të grumbullojmë informacione për banorët lokalë
- Të shikojmë parashikimin e motit (shiu, bora, era)
- Varësisht nga stina, të sigurojmë xhaketa kundër shiut dhe erës, pantallona kundër shiut dhe erës, këpucë të thella kundër shiut, të brendshme dhe çorapë rezervë
- Minimum 2 litra ujë më vete dhe së paku një vakt ushqimi

Raportimi gjatë vërshimeve

Raportimi për vërshimet është tejet i vështirë dhe kërkon kujdes të shtuar nga gazetarët. Varësisht nga niveli i vërshimeve, varen edhe vështirësitë për gazetarët.

Këto janë disa nga masat që duhen marrë para nisjes dhe gjatë kryerjes së terrenit:

- Të sigurohemi për parashikimet e motit, ta dimë se çfarë na pret gjatë orëve/ditëve/javëve në vijim
- Të sigurojmë xhaketa kundër shiut, mbrojtës najloni, çizme të thella, ujë të pijshëm dhe ushqime
- Në terren të mos futemi thellë në zonat e përmbytura
- Të shtohet kujdesi që të mos mbesim të ngujuar nga uji
- Të marrim më vete një kuti të ndihmës së parë të pajisur mirë me mjetet e nevojshme
- Duhet krijuar një strategji daljeje dhe një vend i sigurt për t'u kthyer, nëse është urgjentisht e nevojshme
- Të mos ecim nëpër rrugë ose përrenj të përmbytur



- Të jemi vigjilentë për çdo kafshë të egër që mund të jetë arratisur
- Kur ecim nëpër zonat e përmytura duhet të kemi kujdes të shtuar për kanalet, kanalizimet, vrimat apo pusetat e pambuluara

Raportimi për zjarret

Çdo gazetar që raporton për zjarret duhet të jetë në gjendje të mirë shëndetësore, fizike dhe psikologjike, sepse zjarret përbëjnë një prej terrereve me faktorë të ndryshëm të rrezikut. Është i nevojshëm një vlerësim i plotë i rrezikut, si dhe një plan konkret se si ta mbajmë kontaktin me zyrën apo familjarët.

- Sigurohemi që dikush të jetë në dijeni të vendndodhjes dhe qëllimeve tona
- Sigurohemi që të kemi mjete të duhura komunikimi, përfshirë telefon apo radiolidhje, por duhet pasur kujdes pasi përdorimi i radiolidhjes nuk është i lejueshëm pa leje speciale në disa shtete të botës

Çfarë duhet pasur parasysh?

Ekspertët e zjarreve rekomandojnë që në vatrat e përfshira nga zjarri të mos punohet vetëm, pavarësisht a është fjala për gazetarë apo për kameramanë/fotoreporterë.

Disa këshilla praktike:

- Nuk këshillohet të punosh i vetëm në vendin e zjarrit, për shkak të mjedisit të rrezikshëm
- Nëse punoni së bashku me zjarrfikësit, kushtojuni vëmendje udhëzimeve të tyre
- Identifikoni pikat kryesore që mund t'ju ndihmojnë të orientoheni nëse humbisni
- Shmangni pozicionimin në kodra mbi zjarret, sepse zjarri ngjitet me shpejtësi
- Asnjëherë mos e poziciononi veten midis dy fronteve që janë duke u djegur
- Njerëzit lokalë të prekur nga zjarret mund të jenë të mërzitur ose të zemëruar pasi kanë humbur familjarë apo u janë djegur pronat, andaj pyetini para se t'u afroheni

- Mos shkoni në asnjë rrethanë në terrene të tilla pa mjetet e nevojshme të sigurisë, duke përfshirë maskën profesionale, rrobat kundërzjarrit dhe pajisje të tjera që mund të jenë vendimtare në raste të rrezikut

Raportimi për tërmetet

Sipas Rrjetit të Gazetarisë së Tokës, kur ndodh një fatkeqësi, storia më e rëndësishme që gazetarët mund t'i tregojnë audiencës së tyre në radhë të parë duhet të jetë rreth sigurisë, se çfarë duhet të bëjnë për të qenë të sigurt, ku mund të shkojnë nëse kanë nevojë për ndihmë dhe udhëzimet e kujt duhet t'i ndjekin.

Më shumë në këtë link: <https://earthjournalism.net/resources/reporting-on-disasters>

Këto rregulla dhe sugjerime vlejnë sidomos në raportimet për tërmetet, pasi raportimi për këso katastrofash natyre është tejet i vështirë për gazetarët. Së pari për shkak të rrezikut të përsëritjes së tërmetit, për shkak të kaosit që shkaktohet dhe rrezikut nga shembja e objekteve të dëmtuara nga tërmeti. Por, janë edhe faktorë të tjerë të cilët mund ta vënë gazetarin para ndonjë kërcënimi serioz, siç është p.sh. rreziku nga grabitjet, kërcënimet verbale e fizike, si dhe bllokimi në zonën e tërmetit.

Disa këshilla për raportimin për tërmetet:

Pas tërmetit tragjik që ndodhi në Turqi dhe Siri në muajin shkurt të vitit 2023, [gazetarja dhe trajnuesja siriane, Mais Katt](#) dha këshillat e mëposhtme për gazetarët që raportojnë për fatkeqësitë natyrore:

- Jepini përparësi sigurisë suaj; kjo është më e rëndësishme sesa të jesh i pari
- Shmangeni shkuarjen në zona me rrezik të lartë dhe ndiqini rregullat e sigurisë të rekomanduara nga autoritetet lokale, përfshirë ato të sigurisë



- Të respektohet etika gazetareske dhe standardet profesionale kur mbulohen fatkeqësitë
- Respektojini udhëzimet rreth publikimit të fotografive të fëmijëve dhe privatësinë e familjeve të prekura
- Ndiqini udhëzimet profesionale kur intervistoni njerëz që mund të përjetojnë trauma
- Verifikojeni informacionin përpara se ta publikoni, pasi krizat janë një terren pjellor për dezinformata.

Pajisjet e nevojshme

- Merrni rroba adekuate varësisht nga stina në të cilën ndodh tërmeti
- Maska kundër pluhurit, syze, dorëza
- Merrni "Sleepingbag" (Thes fjetjeje)
- Drita me bateri
- "Powerbank" për telefon

Kujdesi gjatë raportimit

- Mos lëvizni afër objekteve shumëkatëshe
- Keni kujdes nga objektet e dëmtuara nga të cilat mund të bien pjesë të forta
- Mos i pengoni ekipet e kërkim-shpëtimit
- Qëndroni në hapësira të hapura ku nuk ka rrezik të shtuar
- Nëse ju zë nata, mos flini në objekte shumëkatëshe, sidomos në ato që janë pjesërisht të dëmtuara



Këshilla shtesë për gazetarët që realizojnë hulumtime në fushën e mjedisit

Varësisht nga terreni nga i cili jeni duke raportuar, keni parasysh edhe këto këshilla shtesë:

- Jini të gatshëm për përballje me dëmtuesit e mjedisit
- Sigurohuni se vendi ku po e kryeni hulumtimin është hapësirë publike
- Nëse është pronë private, kërkoni leje për fotografim/xhirim
- Identifikojeni gjithmonë veten tuaj duke treguar emrin-mbiemrin dhe mediumin
- Nëse ju ndalohet qasja në hapësira publike, jini të gatshëm ta shpjegoni ligjin
- Vendoseni ID-në dhe vishni jelek identifikues "Press"
- Mbrojeni qëndrimin tuaj se raportimi për temën është i rëndësishëm
- Jepjani mundësinë të flasë, të japë versionin e tij/saj
- Nëse konfrontoheni, qëndroni i qetë dhe profesionist
- Nëse ju ofendojnë, mos ua ktheni
- Nëse kërcënoheni verbalisht, mundohuni të largoheni nga vendi
- Nëse sulmoheni fizikisht, thirreni menjëherë policinë apo lajmërojeni në stacionin policor më të afërt.



Mbrojtja e burimeve

Për dallim prej vendeve të ndryshme të botës, burimet e gazetarëve në Kosovë janë të mbrojtura me ligj. Në vitin 2013, Kuvendi i Kosovës votoi "Ligjin për mbrojtjen e burimeve të gazetarisë".

Ky ligj është i zbatueshëm për të gjithë gazetarët dhe profesionistët e tjerë të medias që janë të angazhuar në mbledhjen, përgatitjen dhe shpërndarjen e informacionit nëpërmjet medias.

Sa herë që gazetarët mund të përballen me presione apo tendenca për t'i zbuluar burimet e tyre të informacionit, duhet të kenë parasysh mbrojtjen që u ofron ky ligj.

Ligji thotë në mënyrë specifike se gazetarët dhe profesionistët e tjerë të medias kanë të drejtën e heshtjes rreth burimeve të informacionit. Pra, gazetarët nuk mund të detyrohen t'i zbulojnë burimet e informacionit ose të japin materiale që ndër të tjera:

- mund të zbulojnë identitetin e burimeve të tyre të informacionit
- mund të zbulojnë natyrën apo origjinën e informacionit të tyre
- mund të zbulojnë identitetin e një autori të një teksti ose të një produkti audio-vizual
- mund të zbulojnë përmbajtjen e informacioneve dhe vetë dokumenteve, nëse kjo gjë mund të çojë tek identifikimi i burimit

Por, ligji parasheh edhe situata kur gazetarët janë të obliguar të zbulojnë identitetin e burimit të informacionit, por kjo ndodh vetëm me kërkesë të gjykatës kompetente dhe vetëm nëse: zbulimi i identitetit të burimit të informacionit është i nevojshëm për të parandaluar një kërcënim serioz të integritetit fizik me pasojë vdekjen të një ose më shumë personave.

Më shumë për ligjin: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8864>

Si të veprojmë në raste të rrezikut apo të sulmeve?

Një udhëzues i mirë ku mund të gjenden shumë përgjigje për këtë pyetje është "Udhëzuesi për Sigurinë e Gazetarëve - Manual për gazetarët në mjedise me rrezik të lartë" i Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë - UNESCO dhe organizatës "Reporterët pa Kufij". Linku: <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000243986>

Por në Kosovë, gazetarët sa herë që mund jenë viktimë të sulmeve verbale apo fizike, rekomandohet që në momentin e parë ta thërrasin Policinë e Kosovës.

Numrat për raste urgjente. Nga telefonja fikse dhe mobile: **192** ose **038 550 999**.

Gjithmonë telefononi Policinë e Kosovës. Gjithmonë raportoni rastet e kërcënimeve dhe të sulmeve fizike. Ndryshe, ato mund të përsëriten.

Shpjegoni dhe thoni të vërtetën në momentin që intervistoheni nga Policia. Nëse sulmi është më i rëndë, kërkoni trajtim mjekësor. Ruani raportet mjekësore. Ju duhen në proces gjyqësor.

Qetësojeni veten. Kujdesuni për shëndetin tuaj mendor. Kërkoni ndihmë profesionale në rast se ndieni nevojë.

Pasi të keni përfunduar punë në polici, njoftoni organizatat që mbrojnë të drejtat e gazetarëve. Njoftojeni Asociacionin e Gazetarëve të Kosovës, si dhe kërkoni mbështetjen e Federatës Evropiane të Gazetarëve (EFJ) dhe të Federatës Botërore të Gazetarëve (IFJ).

AGK: <https://agk-ks.org/> Email: office@agk-ks.org,
Mob: **+383 (0) 48 101 155**

EFJ: <https://europeanjournalists.org/contact-us/>

IFJ: <https://www.ifj.org/contact.html>

Në rast se ju duhet avokat për përfaqësim gjyqësor, shikoni mundësitë e ofrimit të kësaj ndihme falas apo në bashkëpunim me Asociacionin e Gazetarëve të Kosovës (AGK), por edhe me organizata të tjera që ofrojnë ndihmë juridike falas, përfshirë Institutin e Kosovës për Drejtësi (IKD). Mos lejoni që një rast i caktuar t'ju jua humb vullnetin për të vazhduar me denoncimin e fenomeneve negative dhe shkeljeve të ligjeve të aplikueshme në Republikën e Kosovës.





10 KËSHILLA SE SI TË RAPORTOHET PËR MJEDISIN

Stephen Leahy, një gazetar që ka marrë shumë shpërblime për raportimet për mjedisin, ka dhënë 10 këshilla se si të raportohet për çështje të mjedisit. Sipas tij, shkenca dhe çështjet mjedisore mund të jenë sfiduese për t'u kuptuar nga publiku për shkak të gjuhës teknike dhe kompleksitetit, kështu që gazetarët duhet të veprojnë si përkthyes duke përdorur gjuhë të qartë, koncize dhe shembuj përkatës për ta shpjeguar secilin problem.

10 këshillat:

1. Mësoni shkencën shumë mirë, me sa më shumë detaje të jetë e mundur. Është e vetmja mënyrë për të shkruar qartë. Ruajeni veten që të mos mashtroheni
2. Asnjëherë mos kini turp të thoni 'Nuk e kuptoj'. Është roli i ekspertit t' i ndihmojë gazetarët që ta bëjnë punën e tyre për t'i bërë kërkimet ose gjetjet të kuptueshme për publikun
3. Gjatë intervistave pyetini burimet se si do t'i shpjegojnë gjetjet e tyre nëse do të flisnin me një fqinj. (Nëse kjo është ende shumë e ndërlikuar, pyesni se si do t'ia shpjegojnë një fëmijë 10-vjeçar)
4. Për shkak se nuk mund të dini gjithçka, sigurohuni që të përdorni burime që janë të besueshme dhe që nuk kanë një agjendë të fshehur. Disa shkencëtarë ose ekspertë kanë interesa të caktuara ose paguhet nga korporatat dhe grupet lobuese. Këtu përfshihen OJQ-të dhe qeveritë

5. Historia duhet t'u përgjigjet këtyre katër pyetjeve: Pse është i rëndësishëm studimi ose raporti? Si ndikon te publiku? Cilat janë implikimet për njerëzit, rajonin etj? Çfarë duhet bërë?
6. Kontrolloheni përmbajtjen e studimeve të lajmeve, raporteve ose njoftimeve për shtyp me burime të besuara. Ka organizata që paguhen për t'i hutuar gazetarët për çështje teknike ose për të promovuar agjenda të caktuara
7. Pyetni dhe sfidoni të gjitha informacionet dhe argumentet, pa marrë parasysh se nga cila anë vijnë ato. Besueshmëria është gjithçka
8. Shmangni "ai tha-ajo tha", rrëfime që thjesht shkëmbejnë akuza. Zbuloni se çfarë po ndodh në të vërtetë. Për shembull, pothuajse çdo shkencëtar klimatik në botë ka thënë për vite se ndryshimi klimatik po ndodh tani dhe megjithatë disa media ende citojnë burime që thonë "jo, nuk është". Do të ketë gjithmonë pikëpamje të kundërta - dikush që thotë se Toka është e sheshtë - por pse t'i citojmë ato në një histori? Kur nuk është e qartë, bëni një vlerësim të saktë të secilit argument dhe më pas vendosni se cili meriton vëmendje, ose vini në dukje të metat
9. Dilni jashtë dhe takoni njerëz të përfshirë në çështje mjedisore, duke përfshirë ata që preken drejtpërdrejt
10. Global është Lokal dhe Lokal është Global. Pothuajse të gjitha aspektet e historive mjedisore janë lokale. Ndryshimet klimatike, uji, ushqimi, ndotja, zhvillimi i qëndrueshëm, biodiversiteti etj., kanë kënde lokale. Por këto histori janë gjithashtu globale, sepse një çështje mjedisore lokale me siguri përsëritet në shumë vende të tjera anembanë botës.



Ide për storie për ambientin në Kosovë

Ku mund t'i gjej idetë?

Idetë mund t'i gjeni nga vëzhgimi personal që shihni çdo ditë në rrugët e Kosovës, në shtypin lokal, nga shumë organizata të ndryshme që merren me çështje për ambientin, si dhe në vende të tjera.

Këtu i keni disa ide për të cilat mund të raportoni:



Ndotja nga Kosova A dhe Kosova B

Çfarë niveli është ndotja?

Sa persona vdesin nga kjo ndotje?

Pse nuk po instalohen filtrat?

A janë termoelektranat më të ndotura në Evropë?

Çka thonë banorët që jetojnë afër tyre?

Çka thonë mjekët?




Zhdukja e kafshëve të egra

Pse zhduken kafshët e egra në Kosovë?

Kush ua shkatërron habitatin atyre?

A është gjuetia legale dhe kur?

Çfarë lloj kafshësh të egra ka në Kosovë?



Gurthyesit

Sa gurthyes janë në Kosovë?

Pse nuk kthehen në gjendje paraprake?

Çfarë rreziku u kanoset njerëzve dhe kafshëve nga këto gropa të mëdha?



Shkarkimi i ujërave industriale në lumenj

Cilat fabrika shkarkojnë ujërat industriale në lumenj?
Si ndoten ujërat nëntokësore?



Djegia e maleve

Në cilat rajone ka më shumë djegie të maleve?
A janë ekipet e emergjencave të përgatitura për të shuar zjarrin?


Çfarë ndikimi ka njeriu në këto zjarre?
Sa persona janë ndjekur penalisht për zjarrvënie të qëllimshme?



Kanalizimet që shkarkohen në lumenj

Sa fabrika janë në Kosovë për trajtimin e ujërave të zeza?
Pse kanalizimet shkarkohen në liqene nga ku merret uji i pijshëm?

Pse ato shkarkohen në lumenj?



Deponitë ilegale

Sa deponi ilegale janë në Kosovë?
A ka dështuar projekti për eliminimin e tyre? Pse njerëzit hedhin mbeturina anash rrugës dhe a ka vende të caktuara për materiale inerte?



Energjia nga panelet solare

Sa ka Kosova kapacitete për energji solare?

A mund të vendosin qytetarët panele solare në shtëpi të tyre?

A mund ta shesin energjinë elektrike të prodhuar?



Vërshimet

Pse në Kosovë ka vërshime, edhe për faktin se është vend kodrinor-malor? Si u shkatërruan shtretërit e lumenjve?

A i ndihmon qeveria ata që janë të prekur nga vërshimet?



Energjia nga era

A ka Kosova kapacitete për prodhim nga era?

A është kjo teknologji e shtrenjtë? Sa turbina tashmë janë në Kosovë? Ku mund të instalohen turbina të tjera?



Mbipopullimi

Pse ndërtohen shumë banesa por jo parqe?

A ka Kosova plan kombëtar për planifikim të vendbanimeve?



Thëngjilli

Sa ka thëngjill Kosova?
Çfarë lloji është?

Edhe sa mund ta përdorë Kosova
thëngjillin?

Çfarë sëmundjeje shkakton djegia e
thëngjillit?



Shkatërrimi i shtratit të lumenjve

Cilët lumenj janë të prekur?
Cilat kompani marrin zhavorr nga
këta lumenj?

Çka thotë ligji?
Çka po bën qeveria ose komunat për
ta ndalur një gjë të tillë?



Deponitë e mbeturinave

Çfarë ndotje krijohet afër këtyre
deponive?
Ku shkarkohet uji i ndotur nga
deponitë?

Pse lejohen fëmijët të mbledhin
mbeturina brenda?



Mbetjet industriale

Çfarë ndodh me mbetjet industriale në shumë lokacione?

Sa janë të rrezikshme?
Kush duhet dhe a mund të largohen?



Zhdukja e tokave bujqësore

Sa hektarë toka janë zhdukur që nga mbarimi i luftës?

Pse ndërtohen shtëpi në toka bujqësore?

Cilat rajone janë më të prekura?



Djegia e mbeturinave

Pse çdo ditë mund të shihet diku një zjarr nga djegia e mbeturinave?

Çka thotë ligji?

Sa dënime janë shqiptuar më muajt/vitet e fundit?



Prerja ilegale e pyjeve

Sa hektarë tokë pyje zhduken në Kosovë çdo vit?

Cilat male dëmtohen më së shumti?
Çka thotë ligji për parqet kombëtare?

Si t'i kontaktoni organizatat vendore dhe ndërkombëtare:

| Nr. | Organizata | Website |
|-----|---|--|
| 1 | United Nations Environment Programme (UNEP) | www.unep.org |
| 2 | United Nations Human Settlements Programme (UN-Habitat) | https://unhabitat.org/ |
| 3 | European Environment Agency (EEA) | www.eea.europa.eu |
| 4 | WWF | www.worldwildlife.org |
| 5 | 350 | 350.org |
| 6 | <u>Climate Foundation</u> | www.climatefoundation.org |
| 7 | Greenpeace | www.greenpeace.org |
| 8 | <u>Earth Island Institute</u> | www.earthisland.org |
| 9 | <u>Rainforest Action Network</u> | www.ran.org |
| 10 | <u>Friends of the Earth International</u> | www.foei.org |
| 11 | <u>Global Footprint Network</u> | www.footprintnetwork.org |
| 12 | Depave | depave.org |
| 13 | <u>Earth Day Network</u> | www.earthday.org |
| 14 | <u>Natural Resources Defense Council (NRDC)</u> | www.nrdc.org |
| 15 | Rainforest Alliance | www.rainforest-alliance.org |
| 16 | <u>Earthjustice</u> | earthjustice.org |
| 17 | <u>The Climate Reality Project</u> | www.climate realityproject.org |
| 18 | <u>Restore the Earth Foundation</u> | restoretheearth.org |
| 19 | <u>C40 cities</u> | www.c40.org |
| 20 | Biofuelwatch | www.biofuelwatch.org.uk |

| | | |
|--------|--|--|
| 2 1 | Foundation for Environmental Education (FEE) | www.fee.global |
| 2 2 | Friends of Nature | f-o-n.org |
| 2 3 | International Institute for Environment and Development (IIED) | www.iied.org |
| 2 4 | Society for the Environment (SocEnv) | socenv.org.uk |
| 2 5 | <u>Earthworks</u> | earthworks.org |
| 2 6 | Environmental Defense Fund (EDF) | www.edf.org |
| 2 7 | The Carbon Underground | thecarbonunderground.org |
| 2 8 | Green Cross International (GCI) | www.gcint.org |
| 2 9 | Fauna and Flora International | www.fauna-flora.org |
| 3 0 | United States Environmental Protection Agency(EPA) | www.epa.gov |
| 3 1 | Balkan Green Foundation | www.balkangreenfoundation.org |
| 3 2 | Global Environment Facility (GEF) | www.thegef.org |
| 3 3 | Intergovernmental Panel on Climate Change (IPCC) | www.ipcc.ch |
| 3 4 | International Network for Sustainable Energy (INFORSE) | www.inforse.org |
| 3 5 | Panthera Corporation | panthera.org |
| 3 6 | International Union for Conservation of Nature (IUCN) | www.iucn.org |
| 3 7 | European Environmental Bureau (EEB) | eeb.org |

| | | |
|--------|---|--|
| 3 8 | Creative Environmental Networks (CEN) | www.cen.org.uk |
| 3 9 | Institute of Environmental Sciences and Technology | www.iest.org |
| 4 0 | TreePeople | www.treepeople.org |
| 4 1 | Bioversity International | www.bioversityinternational.org |

| Nr | Organizata | Website |
|----|--|---|
| 1 | Center for Education and Development of Environment (CEDE) | https://cede-ks.org/ |
| 2 | Keep it Green | https://kigngo.com/ |
| 3 | Youth Ecological and security zone - EcoZ | https://www.facebook.com/Yecozone/ |
| 4 | GAIA | https://www.gaia-ks.com/ |
| 5 | Organizata Kosovare për Talent dhe Arsim - TOKA | https://toka-ks.org/ |
| 6 | Green Kosovo Caring For Kosovo Animals And Environment | http://www.greenkosovo.org/ |
| 7 | Let`s do it Kosova | https://tapastrojmekosoven.org/ |
| 8 | EcoKoswomen | |
| 9 | Organizata per Mbrojtjen e Mjedisit - Gjethi | https://gjethi.org/?fbclid=IwAR1FK_v52mY16IaTYG9QizWH5CwYqCv3bJrxFviG6tX01G5uwJ-vicVQW_s |
| 10 | Ekovizioni | http://www.ekovizioni.com/ |
| 11 | Fondacioni Jeshil | https://fondacionijeshil.org/ |
| 12 | KEERC - Kosova Environmental Education & Research Center | Keerc.com |
| 13 | PEN - Peer Educators Network | https://ngo-pen.com/ |

| Nr. | Institucioni | Website |
|-----|---|--|
| 1 | Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës | www.mit-ks.net |
| 2 | MMPHI - Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës(AMMK) | www.ammk-rks.net |
| 3 | Sistemi Informativ Ujor (SIU) | siu.rks-gov.net |
| 4 | MBPZHR - Departamenti i Pylltarisë | www.mbpzhr-ks.net/sq/departamenti-i-pylltarise |
| 5 | MBPZHR- Agjencia e Pyjeve të Kosovës | www.mbpzhr-ks.net/sq/agjencia-e-pyjeve-te-kosoves |
| 6 | MMPHI - Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës | ihmk-rks.net |
| 7 | Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM) | www.kosovo-mining.org |
| 8 | ME- Shërbimi Gjeologjik i Kosovës | me.rks-gov.net/sq/sherbimi-gjeologjik-i-kosoves#.ZBxfCnbMJPY |
| 9 | ME-Agjencia e Kosovës për Eficiencë të Energjisë | me.rks-gov.net/sq/agjencia-e-kosoves-per-eficience-te-energjise#.ZBxffnbMJPY |
| 10 | Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë | www.fkee-rks.net |

Referencat:

Everton, N. (1999) Making Television News, Reuters Foundation, Londër

Boyd, A. (2001) Broadcast Journalism, Techniques of Radio and Television News, Focal Press, Londer

Millerson, G. (2000) Video Production Handbook, Focal Press, Londer Millerson,

G. & Owens, J. (2009) Television Production. Focal Press, Londer

Rudin, R. & Ibbotson, T. (2002) An Introduction to Journalism. Focal Press, Londer

Underwood, R. (2007) Roll! Shooting TV News, Focal Press, Londer

Online:

Safety and Security for Environmental Journalists (earthjournalism.net)

Hostile Climate for Environmental Journalists (rsf.org)

Safety Guide for Journalists: A Handbook for Reporters in High-risk Environments (unesco.org)

Reporting on Disasters (earthjournalism.net)

Asma Hamdi Qandil: Journalists share their experiences, advice for covering the Turkey-Syria earthquake (ijnet.org)

Peter Nelson: Ten Practical Tips for Environmental Reporting (agua.org)

Seven Tips for Student Journalists Covering Climate Change (journalism.uoregon.edu)

